



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror


Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2019, pasi e shqyrtoi Propozim-strategjinë për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës (2019-2021), mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës (2019 – 2021) “Kuvend i hapur, pjesëmarrje qytetare”.

Nr: 06-V- 438

Prishtinë, 18.01.2019

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Vendimi dhe Strategjia u dërgohen:

- Administratës së Kuvendit dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo –Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës
(2019 – 2021)

“Kuvend i hapur, pjesëmarrje qytetare”

Prishtinë, janar 2019

Hyrje

Komunikimi i institucioneve shtetërore me qytetarët, është një element i funksionimit të demokracisë dhe një pjesë qenësore e veprimitarisë së përditshme politike. Kontrolli publik mbi institucionet shtetërore nuk mund të ushtrohet pa njohuri të mjaftueshme për punën që bëhet brenda atyre institucioneve.

Në këtë aspekt, aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të jenë tërësisht transparente dhe të qasshme për mediat, shoqërinë civile dhe publikun në përgjithësi.

Synimi i Strategjisë për informim dhe komunikim të Kuvendit të Republikës së Kosovës është rritja e sasisë dhe cilësisë së informatave në dispozicion të publikut për punën e Kuvendit, duke avancuar kështu kontributin e publikut në proceset ligjvënëse dhe mbikëqyrëse, si dhe duke kontribuar në reputacionin e Kuvendit. Si i tillë, dokumenti ndikon dhe kërkon përfshirjen e kryetarit të Kuvendit, të deputetëve të tjerë dhe administratës së Kuvendit.

Strategjia për informim dhe komunikim paraqitet si një dokument i azhurnuar (përditësuar) pas vlerësimit të progresit të bërë nga Kuvendi i Kosovës në hartimin dhe shpërndarjen e informatave.

Kjo strategji është krijuar në konsultim me publikun dhe si rezultat i përfshirjes së tyre në punën parlamentare. Dokumentet strategjike, të cilat veçse janë përkthyer në veprime konkrete, si dhe zhvillimet e reja, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e bënë të domosdoshëm rishikimin në mënyrë të konsiderueshme të dokumentit të mëparshëm strategjik.

Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka shndërruar dialogun me shoqërinë civile në partneritet, ka afuar hulumtime të besueshme për komisionet parlamentare, si dhe ka afuar ekspertiza në hartimin e ligjeve dhe politikave. Me qëllim të përmirësimit dhe përmbushjes së të gjitha këtyre detyrimeve që rrjedhin nga vlerësimi i bërë, kjo strategji synon të rrisë efikasitetin e punës dhe përgjegjësinë ndaj qytetarëve të Kosovës. Kjo duhet të arrihet nëpërmjet komunikimit efektiv, adresimit të çështjeve të cilat duhet diskutuar, së bashku me ndarjen e përgjegjësisë, nëpërmjet një dizajnimi të prioriteteve dhe aktiviteteve, në mënyrë që ky dokument të jetë i besueshëm dhe i zbatueshëm.

Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës është pjesë përbërëse e Planit Strategjik të Kuvendit të Kosovës 2016 - 2020, bazuar në misionin dhe vizionin që Kuvendi të jetë institucion efektiv, transparent e demokratik.

Drejtorja për media dhe marrëdhënie me publikun do të jetë qendër koordinuese dhe mbikëqyrëse e zbatimit të strategjisë.

Kontakti: Musli Krasniqi, drejtor, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, email: info.dmmp@rks-gov.net; tel: +381 38 211 186

Objektivi e përgjithshëm i Strategjisë

Objektiv i përgjithshëm i kësaj strategjie është avancimi i transparencës, rritja e komunikimit me qytetarë dhe forcimi i rolit përfaqësues të deputetëve, duke siguruar informata të shpejta dhe të sakta për Kuvendin, duke rritur qasjen e publikut në informata dhe në punën e Kuvendit, si dhe duke informuar publikun për punën e deputetëve dhe funksionet e tyre.

Grupet e synuara (targetuara)

Opinionii publik Institucionet Publike	<ul style="list-style-type: none">• Qytetarët e Kosovës• Qeveria• Institucionet e pavarura• Gjykatat• Komunitat
Universitetet dhe shkollat para-universitare	<ul style="list-style-type: none">• Universitetet publike të Kosovës• Kolegjet private• Shkollat e mesme dhe ato fillore
Diaspora	<ul style="list-style-type: none">• Mërgimtarët• Organizatat përfaqësuese të Diasporës• Bizneset në Diasporë
Mediat e shkruara dhe elektronike	<ul style="list-style-type: none">• Televizioni publik dhe televizionet private• Radiot publike dhe private• Gazetat• Agjencitë e lajmeve• Portalet
Shoqatat e biznesit	<ul style="list-style-type: none">• Oda Ekonomike e Kosovës dhe odat e tjera të huaja,• Organizatat biznesore dhe sipas sektorëve
Organizatat jo-qeveritare	<ul style="list-style-type: none">• Organizatat jo-qeveritare në nivel qendror dhe atë lokal,• Organizatat jo-qeveritare të huaja
Organizatat e huaja	<ul style="list-style-type: none">• USAID• NDI• GIZ• OSBE• UNDP• Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
Parlamentet	<ul style="list-style-type: none">• Bashkëpunimi ndërparlamentar

Objektivat strategjike

Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës synon të zhvillojë një platformë të qëndrueshme të procesit të komunikimit në mes të qytetarëve dhe Kuvendit, nëpërmjet grupit të objektivave vijuese.

- Objektivi 1. Avancimi i rolit përfaqësues të deputetëve në komunikim me qytetarët
- Objektivi 2. Fuqizimi i marrëdhënieve me mediat dhe partneritetit me shoqërinë civile
- Objektivi 3. Informimi i publikut lidhur me procesin e integritetit evropian
- Objektivi 4. Fuqizimi i DMMP-së

Objektivi 1. Avancimi i rolit përfaqësues të deputetëve në komunikim me qytetarët

Një kulturë e hapjes, llogaridhënies dhe qasjes në Kuvend do të avancojë ndjeshëm rolin përfaqësues të deputetëve dhe do t'i përmirësojë proceset e komunikimit me qytetarë.

Krijimi i një kulture të tillë mund të arrihet nëpërmjet rritjes së besimit të qytetarëve ndaj Kuvendit, duke afruar informata të mjaftueshme, të qasshme, të lehta për t'u kuptuar, publikime, hulumtime dhe informata të tjera që janë në interes të të dyja palëve.

Zhvillimi i përgjithshëm shoqëror e teknologjik ka krijuar në vazhdimësi mundësi dhe instrumente të reja të komunikimit midis institucioneve dhe publikut. Në veçanti, përdorimi i internetit dhe sistemet e komunikimit digjital, kanë krijuar mundësi të reja për rritjen e komunikimit midis qytetarëve dhe politikanëve.

Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve të më poshtme.

(Detajet e mëtejshme të veprimeve specifike, së bashku me treguesit e zbatimit të suksesshëm në secilën nga këto fusha janë përfshirë në Planin e Veprimit).

1.1 Përmirësimi (përditësimi) i faqes së internetit të Kuvendit

Të sigurohet që faqja e internetit afron apo siguron informata relevante dhe cilësore, qasjen mobile në të dhënat parlamentare, si dhe fleksibilitetin në llojin e pajisjeve harduerike të përdorura për të hyrë (qasur) dhe përdorur e-parlamentin. Kjo do t'i mundësojë Kuvendit ta informojë publikun në kohë reale në lidhje me procesin e legjislacionit, nëpërmjet Sistemit për përcjelljen e Legjislacionit në faqen e internetit të Kuvendit (shih aktivitetin 2.2).

1.2 Komunikimi digjital

Fuqizimi dhe përditësimi i sistemeve të teknologjisë informative, si dhe përmirësimi i vizionit të Kuvendit në lidhje me përdorimin e teknologjisë informative dhe TIK-ut, do të jenë prioritet i

institucionit në muajt dhe vitet në vijim. Në veçanti, Kuvendi do të sigurojë qasjen në informata përmes një game të gjerë kanalesh digjitale, duke përfshirë: televizionin, kanalet mobile, mediat sociale dhe ueb-in, si dhe duke hapur faqet zyrtare në rrjetet sociale: Facebook, YouTube dhe Twitter.

1.3 Publikimet

Publikimet të cilat afron Kuvendi i Kosovës, duhet të jenë lehtë të kuptueshme dhe të qarta në mesazhin që e përçojnë, nëpërmjet përdorimit të një dizajni të mirë dhe gjuhës së thjeshtë e të qartë. Në Kuvend duhet të krijohet Këshilli Redaktues për ta siguruar një gjë të tillë. Ky organ (në koordinim me Kryesinë dhe Kabinetin) do ta marrë përgjegjësinë për përcaktimin e përmbajtjes kryesore të të gjitha publikimeve, duke përfshirë edhe përmbajtjen e ueb-faqes dhe bërjen e ndryshimeve të nevojshme, si dhe menaxhimin e zhvillimeve të mëtejme teknologjike dhe aplikimin e tyre nëpërmjet projekteve zhvillimore të kësaj natyre. Në kuadër të aktiviteteve për mbështetje të programit të publikimeve të Kuvendit dhe koordinimit me Këshillin e ri Editorial, veprimet kryesore vijuese vihen në pah:

- **Menaxhimi i publikimeve** – Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, mbikëqyrë përgatitjen e publikimeve të ndryshme për punën e Kuvendit dhe gjithashtu koordinon aktivitetet me Këshillin Redaktues, duke nxitur ekspertë e fushave të ndryshme dhe deputetë që të shkruajnë për situatat dhe zhvillimet aktuale, që janë me rëndësi për vendin, siç është procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian etj. Nëse vlerësohet se është e domosdoshme të punësohen anëtarë të rinj të stafit punues, atëherë mund të merret parasysh apo të shqyrtohet edhe rritja e numrit të botimeve, të tilla si: botime dokumentare të Kuvendit, përmbledhje të seancave plenare në një seri botimesh, mbledhjet dhe vendimet e Kryesisë sipas legjislaturave, përmbledhje të rezolutave etj.
- **Revista “Kuvendi”** – Aktualisht revista e Kuvendit afron një përmbledhje të shkurtër dhe koncize të aktiviteteve të Kuvendit në baza dymujore. Revista duhet të përmbajë informata mbi tema kyçe dhe çështjet aktuale që debatohen në Kuvend, si: procesi ligjvënës, rezolutat e miratuara, raportet e komisioneve, veprimtaritë e anëtarëve të Kryesisë dhe të deputetëve etj. Duhet trajtuar mundësia e publikimit 6-mujor (duke rritur numrin e faqeve), me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe mbulimit tematik të revistës.
- **Fletëpalosjet (fletët informuese)** - Të përgatiten fletëpalosje (“fletët informuese”), të cilat do të shpjegojnë se si funksionon Kuvendi. Fletëpalosjet duhet të mbulojnë tema si Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit, fushëveprimi i secilit komision parlamentar, ndërtesa e Kuvendit, si dhe ngjarjet më rëndësi në Kuvend.
- **Doracakët udhëzues** - Kuvendi përgatitë doracakë të ndryshëm për punën e Kuvendit, si përdorimi i teknologjisë informative, përafrimi i legjislacionit, parimet e integritetit, kodi i etikës, protokollin e Kuvendit etj. Këto publikime do të vendosen në faqen e Kuvendit dhe mund t’u shpërndahen mediave dhe grupeve të vizitorëve (në Qendrën e Kuvendit për Vizitorë), si dhe të afrohen si mjete edukative (arsimore) për deputetët, stafin e Kuvendit dhe publikun e gjerë.

- **Kalendari i Kuvendit** – Zyra e Sekretarit do të përgatisë një kalendar vjetor për të gjitha ngjarjet e rëndësishme që do të zhvillohen brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë takimet apo iniciativat e rëndësishme të parlamenteve dhe institucioneve ndërkombëtare. Kalendari do të publikohet në ueb- faqen e Kuvendit.

1.4 Programet edukative

Kuvendi i Kosovës do të zhvillojë programe të reja edukative për të rinjtë, të përbëra nga një seri video-xhirimesh dhe animacionesh për të shpjeguar historikun e Kuvendit, rolet dhe funksionet e tij, si dhe proceset kyçe të Kuvendit. Të gjitha materialet do të publikohen në ueb- faqen e Kuvendit dhe në Qendrën për Vizitorë, që do të përdoren për rritjen e vetëdijes së komunitetit.

Duhet të arrihet një marrëveshje me televizionin publik për transmetimin e kronikës javore dhe planit të punës së Kuvendit për javën që vjen. Kronika do të duhej t'i paraqiste aktivitetet parlamentare, p.sh. duke bërë një përmbledhje të ngjarjeve nga java e kaluar, ligjeve të reja, intervistave me anëtarët e Kryesisë, kryesuesit e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët, si dhe do të duhej t'i theksonte mesazhet që Kuvendi dëshiron t'ia përçojë publikut të gjerë.

1.5 “Ditët e Kuvendit”

Kuvendi organizon aktivitetin "Ditët e Kuvendit", gjatë të cilit përfaqësuesit e Kuvendit dalin në terren për të komunikuar me qytetarë dhe për t'i informuar ata drejtpërsëdrejti për rolin e Kuvendit.

Aktivitetet e tilla mund të përfshijnë takime rajonale me nxënës, studentë dhe qytetarë, takime me kryetarë të komunave, ose me asamblistë komunalë etj. Gjatë takimeve të tilla, kryetari i Kuvendit mund të shoqërohet nga nënkryetarët e Kuvendit dhe deputetë që vijnë nga zona lokale e caktuar.

1.6 Transmetimi televiziv dhe në ueb- faqe

Seancat e Kuvendit do të vazhdojnë të transmetohen drejtpërdrejt në televizionin publik, në ueb- faqen e Kuvendit, në YouTube dhe në faqen e Kuvendit në Facebook. Kuvendi do të përfitojë direkt, në afat të shkurtër dhe të mesëm, nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve të transmetimit të seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve.

1.7 Zgjerimi i Qendrës së Vizitorëve

Për të vazhduar dhe për ta avancuar më tej praktikën e vizitave të grupeve të qytetarëve në ambientet e Kuvendit, është i nevojshëm zgjerimi i Qendrës së Vizitorëve dhe i fushëveprimit të saj. Qendra aktuale e Vizitorëve dhe hapësira afër saj, në katin përdhes të aneksit, duhet të lidhen fizikisht. Qendra e zgjeruar e Vizitorëve duhet të organizojë programe të veçanta për grupe të ndryshme të shoqërisë. Duhet të organizohen lojëra simuluese për punën e Kuvendit dhe të demokracisë, si dhe gara në vizatim dhe shkrim, për nxënësit e shkollave fillore, të mesme dhe

studentët. Pjesëmarrësit do të shohin mënyrën e funksionimit të parlamentit në praktikë dhe do të mësojnë më shumë në lidhje me parimet e rëndësishme të demokracisë.

Kuvendi vazhdon programin “Punëtoritë për Demokraci - Demos-ti” për nxënësit e shkollave fillore. Nxënësit, përmes përdorimit të metodave interaktive dhe aktiviteteve të përshtatshme për moshën e tyre, të tilla si: fotografitë, shkrimet, ilustrimet dhe vizatimet, mësojnë se si funksionon demokracia parlamentare.

Objektivi 2. Fuqizimi i marrëdhënieve me mediat dhe partneritetit me shoqërinë civile

Strategjia përfshin veprime specifike për të mbështetur partneritetin e forcuar të Kuvendit me: a) mediat; dhe b) shoqërinë civile.

2.1 Marrëdhëniet me media

Mediat i mundësojnë Kuvendit të arrijë te një audiencë më e gjerë, në kohën e duhur, me mesazhe specifike. Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun (DMMP) afron informata bazike (thelbësore) për punimet e Kuvendit, aktivitetet e Kryesisë, komisioneve dhe deputetëve. DMMP-ja aktualisht është duke i ushtruar funksionet, kryesisht, bazuar në zyrën për shtyp të legjislativit. Kjo qasje aktuale mund të rritet duke përdorur një numër veglash të tjera më bashkëkohore. Në veçanti:

- **Konferenca për media** - të vazhdohet praktika e organizimit të konferencave për media pas mbledhjeve të Kryesisë dhe takimeve të tjera në Kuvend, si dhe e lëshimit të komunikatave për ngjarjet që ndodhin brenda Kuvendit dhe për ato që ndodhin jashtë Kuvendit, në të cilat marrin pjesë përfaqësuesit e Kuvendit.
- **Dhoma e mediave** – Edhe pse qasja e mediave në Kuvendin e Kosovës është e mirë, duke u mundësuar përfaqësuesve të tyre qasje në sallat e mbledhjeve dhe takimeve, përmirësime mund të bëhen në përdorimin e dhomës së mediave (prapa sallës së mbledhjeve plenare), duke e plotësuar me inventar të nevojshëm pune. Në këndin e majtë të hollit të Kuvendit (nga hyrja për deputetë) është propozuar që të ngrihet një kënd i ri për media dhe konferenca shtypi, nga ku gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët do të kenë qasje dhe kontakt më të mirë me deputetë. Po ashtu, konsiderohet e nevojshme krijimi i një hapësirë të re të pajisur për gazetarët, te hyrja kryesore e Kuvendit, për përdorim gjatë gjithë ditëve të punës.
- **Njoftimi i gazetarëve me praktikën parlamentare** – të organizohen takime njoftuese për gazetarët e rinj që mbulojnë punën e Kuvendit lidhur me çështjet legjislative dhe të funksionimit të Kuvendit në përgjithësi. Këto takime do të organizoheshin në baza vjetore.

2.2. Partneriteti me shoqërinë civile

Nëpërmjet Forumit për Transparencë, Kuvendi i Kosovës, konform rolit të tij përfaqësues, merr obligime për të avancuar dhe siguruar angazhim më të madh të qytetarëve dhe për ta promovuar

kulturën parlamentare përmes informatave, qasjes në informata dhe në punën e Kuvendit, duke fuqizuar kështu rolin e qytetarëve në procesin legjislativ dhe rritjen e llogaridhënies.

Forumi për Transparencë Parlamentare përgatitë planin vjetor të punës për zbatimin e Deklaratës për Transparencë dhe Deklaratës për Partneritet me Shoqërinë Civile. Aktivitete të përbashkëta me shoqërinë civile do të ndërmerren për të promovuar pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit të Kosovës. Në veçanti, theksohen prioritetet e mëposhtme:

- Kuvendi të krijojë infrastrukturë të mjaftueshme për zbatimin e planit të Deklaratës për Partneritet;
- Sistemi për përcjelljen e legjislacionit do të mirëmbahet dhe përditësohet nga Kuvendi;
- Kuvendi së bashku me shoqërinë civile do të organizojë konferencë vjetore;
- Baza e të dhënave e shoqërisë civile do të mirëmbahet dhe përditësohet nga Kuvendi;
- Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe Kuvendit duhet të sigurohet në kuadër të komunikimit për çështje të BE-së.

Objektivi 3. Informimi i publikut lidhur me procesin e integritit evropian

Zbatimi i Marrëveshjes kontraktuale në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës është pjesë e përgjegjësisë institucionale të Kuvendit dhe përpos monitorimit të zbatimit nga qeveria dhe institucionet e tjera shtetërore, ky proces kërkon angazhim parlamentar për t'i informuar qytetarët dhe për të menaxhuar pritjet e tyre, për përgjegjësitë dhe përfitimet që vendi ynë do t'i ketë me zbatimin e marrëveshjes për Stabilizim-Asociim (MSA), si dhe për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Si rezultat, qëllimi i këtij objektivi është ta rrisë rolin e Kuvendit në komunikimin me qytetarët lidhur me procesin e integritit në BE, si dhe ta promovojë dhe intensifikojë rolin e tij në nivelet parlamentare ndërkombëtare.

Në mënyrë që të sigurohet rrjedha e informatave dhe koordinimi ndërmjet aktiviteteve të ndryshme parlamentare mbi çështjet e BE-së, ky objektivi synon që të ndërtohet një koordinim efektiv në mes të të gjitha njësive administrative, përfshirë: Kabinetin e Kryetarit të Kuvendit, Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorinë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare, stafin mbështetës të Komisionit për Integritim Evropian, Drejtorinë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, Drejtorinë për Hulumtime Parlamentare, Bibliotekë dhe Arkiv, Drejtorinë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, si dhe aktorë të tjerë relevantë në këtë proces.

Për më tepër, Kuvendi i Kosovës duhet të intensifikojë koordinimin me Qeverinë e Kosovës, në nivelin politik, si dhe atë administrativ, në lidhje me zbatimin e Strategjisë së komunikimit dhe informimit në mbështetje të Procesit të integritit evropian të Kosovës 2018-2021.

Rritja e bashkëpunimit me institucionet evropiane mbetet qëllim kryesor, me fokus me Parlamentin Evropian dhe shtetet anëtare, në lidhje me avancimin e rolit të Kuvendit të Kosovës në procesin e integritit evropian. Kjo pjesë kërkon që të ketë një lidhje të ngushtë me Strategjinë për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Parlamentare, sapo të miratohet.

Veprimet specifike të propozuara në lidhje me komunikimet rreth integritit në BE janë përmbledhur më poshtë, me detaje shtesë të përcaktuara në Planin e Veprimit:

- 3.1. Përgatitja dhe vendosja e 'Këndit të BE-së' - një kënd informativ rreth BE-së dhe procesit të integritit evropian,
- 3.2. Fushata informuese për ngritjen e vetëdijes lidhur me procesin e integritit evropian,
- 3.3. Dukshmëria publike dhe aktivitetet e komisioneve (p.sh. ditët e hapura, konferencat, mbledhjet e përbashkëta të komisioneve parlamentare, vizitat në terren),
- 3.4. Organizimi i ditës së debatit politik në seancë plenare,
- 3.5. Publikimet lidhur me BE-në dhe procesin e integritit evropian,
- 3.6. Takimet me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile,
- 3.7. Shënimi i Ditës së Evropës.

Objektivi 4. Fuqizimi i DMMP-së

Për implementimin efektiv dhe menaxhimin e mirë të kësaj strategjie, Kuvendi duhet të investojë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe kapaciteteve materiale të Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

4.1. Themelimi i Njesisë së Komunikimit Digjital

Në kuadër të Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, të themelohet dhe funksionalizohet Njësia e Komunikimit Digjital, si dhe të rekrutohet stafi tjetër i nevojshëm: dy zyrtarë për media digjitale, dy zyrtarë për media, një zyrtar për publikime dhe një përkthyes gjuhësor (shqip-serbisht dhe anasjelltas).

4.2. Trajnimi i stafit të DMMP-së

Stafi i DMMP-së, por edhe i drejtorive të tjera brenda Kuvendit, duhet të trajnohet për të siguruar një transparencë më të madhe dhe për publikim të informacionit sa më të saktë për aktivitetet e Kuvendit, si dhe për ta zbatuar këtë strategji (p.sh. metoda e komunikimit, IT, proceset e integritit në BE etj.).

4.3. Koordinimi i brendshëm

Nevojitet zhvillimi i strukturave dhe procedurave administrative dhe raportuese për të mundësuar zbatimin e kësaj strategjie dhe për ta lehtësuar bashkërendimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm.

Aktivitetet e propozuara në këtë fushë janë paraqitur në Planin e Veprimit.

Plani i veprimit për implementimin e Strategjisë për informim dhe komunikim

Objektiva 1. Avancimi i rolit përfaqësues të deputetëve në komunikim me qytetarët						
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Grupet e synuara	Indikatorët matës	Afati	Komentet dhe supozimet	Implikimet buxhetore
1.1. Përmirësimi (përditësimi) i faqes së internetit	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtorja e TI-së, • Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Drejtorja për Çështje Ligjore dhe Procedurale, • Këshilli Redaktues. 	Të gjitha grupet e identifikuara	<p>Faqja e internetit e Kuvendit duhet të ketë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lundrim (navigim) të lehtë për përdoruesit, • Lidhjen me faqet e jashtme relevante midis dokumenteve të miratuara në Kuvend dhe dokumenteve të tjera që rregullojnë të njëjtën çështje, ose trajtimin e çështjeve të ngjashme, • Përputhshmërinë me udhëzimet për ueb- faqet elektronike parlamentare nga Unioni Ndërparlamentar, • Kapacitetin për transmetimin në internet të shumicës së mbledhjeve të Kuvendit. 	Në vazhdimësi	<p>Ueb- faqja parashikon</p> <ul style="list-style-type: none"> • qasjen mobile në të dhënat parlamentare • fleksibilitetin e pajisjeve harduerike të përdorura për të hyrë në të dhënat parlamentare 	40 mijë euro (2019-2021)
1. 2. Komunikimi digjital	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Drejtorja e Teknologjisë Informative, • Drejtorja për Çështje Ligjore dhe Procedurale. 	Të gjitha grupet e identifikuara	<ul style="list-style-type: none"> • Kanalet zyrtare të Kuvendit të hapura në rrjetet sociale, duke përfshirë: Facebook, YouTube dhe Twitter, • Informacionet për faqet zyrtare të Kuvendit të publikuara në mediat sociale, • Informacionet (videoklipet) e publikuara në kanalën zyrtar të Kuvendit në YouTube. 	2019 – në vazhdimësi	<p>Kuvendi do të sigurojë qasje në informata nëpërmjet mjeteve të teknologjive moderne në të gjitha kanalet e mundshme (TV, kanali mobil, media sociale, ueb)</p>	5 mijë euro në vit
1.3. Publikimet e Kuvendit	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Drejtorja për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv, • Drejtorja për Mbështetje të 	Të gjitha grupet e identifikuara	<ul style="list-style-type: none"> • Këshilli Redaktues i themeluar në Kuvend i udhëhequr nga Sekretari i Përgjithshëm; • DMMP-ja kryen rolin e vet në monitorim, koordinim, planifikim etj. • Revista "Kuvendi" vazhdon botimin, 	Në vazhdimësi	<p>Këshilli Redaktues do të përbëhet nga pesë deri në tetë persona: Sekretari i Përgjithshëm, një përfaqësues nga Kabineti i Kryetarit të</p>	

	Komisioneve Parlamentare		<ul style="list-style-type: none"> • Publikohen dhe shpërndahen fletëpalosje për rolin e Kuvendit, organeve punuese dhe procedurën legjislativë të Kuvendit, • Fletëpalosjet për çështjet e MSA-së, • Doracakë të ndryshëm për punën e Kuvendit, si përdorimi i teknologjisë informative, përafrimi i legjislacionit, parimet e integritetit, kodi i etikës, protokollit i Kuvendit etj. • Raportet e punës për punën e Kuvendit, • Kalendari i Kuvendit i mirëmbajtur dhe i publikuar në mënyrë elektronike. 		<p>Kuvendit, Drejtori për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, zyrtari përgjegjës për botime, uebmaster-i, një përfaqësues nga Drejtoria për Çështje Ligjore, një përfaqësues nga Drejtoria e IT-së etj.</p>	<p>Revista “Kuvendi”: 10 mijë euro në vit (KASH)</p> <p>Fletëpalosje: 5 mijë euro në vit (KASH)</p> <p>Doracakë: 3 mijë euro në vit</p> <p>Raportet e punës: 6 mijë euro në vit (KASH)</p>
1.4. Programi edukativ	• Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun	Nxënësit, studentët, publiku i gjerë	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatiten dhe shpërndahen video dhe animacione mbi historinë, rolet, funksionet dhe proceset e Kuvendit. • Një Marrëveshje Mirëkuptimi me televizionin publik për transmetimin e një kronike javore dhe planit të punës së Kuvendit për javën e ardhshme. • Aktiviteti "Dyert e Hapura të Kuvendit", organizohet tri herë në vit: Më 1 qershor - Dita e Fëmijëve; Më 22-23 korrik – Diaspora; Më 15 shtator - "Dita e Demokracisë" 	Në vazhdimësi	<p>Programet edukative që synojnë grupe të ndryshme (p.sh. të rinjtë dhe studentët, publiku i gjerë etj.)</p>	<p>Animacionet: 6 mijë euro në vit</p> <p>- 1 qershori – 6 mijë euro në vit, - Ditët e Diasporës – 6 mijë euro në vit, - Dita e Demokracisë – 10 mijë euro në vit</p> <p>Në bashkëpunim me partnerët</p>

1.6. Ditët Kuvendit	<ul style="list-style-type: none"> • Forumi për Transparencë Parlamentare, • Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun • Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare 	Qytetarët, bizneset, strukturat komunale	<ul style="list-style-type: none"> • Vizita të kryetarit të Kuvendit dhe deputetëve në terren, takime me strukturat komunale, diskutime me qytetarë 	E përvitshme	Koha dhe kohëzgjatja e Javës së Kuvendit duhet të rregullohet çdo fillimvit	6 mijë euro në vit (si dhe në bashkëpunim me partnerët)
1.7. Zgjerimi i Qendrës së Vizitorëve	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria për Shërbime Teknike, • Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. 	Grupet e vizitorëve: nxënës, studentë dhe qytetarë të tjerë	<ul style="list-style-type: none"> • Zgjerimi i hapësirës së Qendrës aktuale të Vizitorëve dhe furnizimi me pajisje e inventar të nevojshëm 	2019-2020	Prokurimi i pajisjeve në bazë të legjislacionit aktual të Kosovës dhe rregullave të prokurimit, ose të donatorëve të identifikuar	Qendra e Vizitorëve: Me projekt të renovimit të objektit
Objektivi 2. Fuqizimi i marrëdhënieve me mediat dhe partneritetit me shoqërinë civile						
Detyrat	Personi përgjegjës	Grupet e synuara	Indikatorët matës	Afati	Komentet dhe supozimet	Implikimet buxhetore
2.1. Marrëdhëniet me media	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Drejtoria për Shërbime Teknike. 	Televizionet, agjencitë e lajmeve, gazetat, portalet, radiot.	<ul style="list-style-type: none"> • Konferencat e organizuara për media, • Këndet e vëna në dispozicion për konferenca për media, • Dhomat dhe këndet e disponueshme për media, • Një hapësirë e re e krijuar në hyrjen kryesore të Kuvendit me pajisjet e nevojshme që do të ishin në shërbim të gazetarëve gjatë ditëve të punës, • Takime informuese me gazetarë. 	2019 – 2021	Aktivitetet të cilat varen nga mbështetja, angazhimi dhe bashkëpunimi i gazetarëve dhe organizatave të medias	<p>Këndet për media: 10 mijë euro</p> <p>Hapësirë e re për media: Me projekt të renovimit të objektit, si dhe mbështetje nga partnerët</p>

2.2. Partneriteti me shoqërinë civile	<ul style="list-style-type: none"> • Forumi për Transparencë Parlamentare, • Zyrtari për koordinim të donatorëve dhe marrëdhënie me shoqërinë civile, • Drejtoria për media dhe marrëdhënie me publikun, • Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale. 	Organizatat e shoqërisë civile	<ul style="list-style-type: none"> • Punëtori me shoqërinë civile të organizuar për të promovuar pjesëmarrjen e publikut në punën e Kuvendit të Kosovës (deri në 7 punëtori në rajone), • Infrastruktura e mjaftueshme e siguruar nga Kuvendi për zbatimin e Planit të Veprimit të Deklaratë për Hapje dhe Transparencë, • Mbajtja e përditësuar e sistemit për përcjelljen e legjislacionit, • Konferenca vjetore Kuvend-Shoqëri Civile për të diskutuar mbi çështjet strategjike për zhvillimin e vendit, • Baza e të dhënave e shoqërisë civile e mirëmbajtur dhe e përditësuar. 	Në vazhdimësi	Të avancohet transparenca parlamentare - informimi transparent parlamentar, qasja në informacionin parlamentar dhe komunikimi elektronik parlamentar	Punëtoritë: 3 800 euro (për një vit) x 4 herë Totali=15,200 euro Konferenca vjetore: 5 mijë euro (për një vit) x 4 herë Totali = 20 mijë euro Baza e të dhënave: 1 mijë euro (KASH)
----------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Objektivi 3 Informimi i publikut lidhur me procesin e integritit evropian

Detyrat	Personi përgjegjës	Grupet e synuara	Indikatorët matës	Afati	Komentet dhe supozimet	Implikimet buxhetore
3. Informimi i publikut lidhur me procesin e integritit evropian	<ul style="list-style-type: none"> • Kabineti i Kryetarit të Kuvendit, • Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, • Drejtoria për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare, • Staf i mbështetës i Komisionit për Integritet Evropian, • Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Zyrtari i lartë për koordinim me donatorë dhe marrëdhënie me shoqërinë civile, 	Të gjitha grupet e identifikuar	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja dhe vendosja e 'Këndit të BE-së' - një qendër informative rreth BE-së dhe procesit të integritit evropian, • Kampanjat për ngritjen e vetëdijes - dëgjimet publike të komisioneve (ditët e hapura, konferenca, takime të përbashkëta të komisioneve parlamentare), • Organizimi i ditës së debatit politik në seancën plenare, • Publikimet në lidhje me BE-në dhe procesin e integritit evropian (linku i ri në ueb-faqe, buletini, broshura, fletëpalosje, materiale të shtypura) • Takimet me media dhe OJQ-të • Shënimi i Ditës së Evropës. 	2019 – në vazhdimësi	Bashkëpunimi me zyrën e BE-së dhe Ministrinë e Integritit Evropian	Këndi i BE-së: 2 mijë euro

	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, • Aktorë të tjerë relevantë. 					Publikimet: 5 mijë euro në vit
Objektivi 4 – Fuqizimi i DMMP-së						
Detyrat	Personi përgjegjës	Grupet e synuara	Indikatorët matës	Afati	Komentet dhe supozimet	Implikimet buxhetore
4.1. Themelimi i Njësisë së Komunikimit Digjital	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Personelit, • Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Kryesia e Kuvendit. 	Publiku i gjerë	<ul style="list-style-type: none"> • Themelimi i Njësisë për Komunikim Digjital dhe rekrutimi i stafit të DMMP-së: • Rekrutimi i dy zyrtarëve për komunikim digjital, • Rekrutimi i dy zyrtarëve për media, • Rekrutimi i zyrtarit për publikime, • Sigurimi i një përkthyesi në gjuhët zyrtare. 	2019-2020	Rekrutimi i ri i nënshtrohet disponueshmërisë së fondeve dhe rregullave që lidhen me angazhimin e stafit të Administratës së Kuvendit	Njësia për komunikim digjital: 20 mijë euro në vit
4.2. Trajnimi i stafit të DMMP-së	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Personelit 	Stafi	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi i stafit (personelit) të DMMP-së dhe personelit tjetër përkatës në temat: • Komunikimi publik, • Botime parlamentare, • Teknologji informative, • Procesin e integrimi evropiane etj. 	Në vazhdimësi	Trajnimi afrohet në bazë të nevojave të identifikuara qartë për trajnim	Plani vjetor i trajnimeve
4.3. Koordinimi i brendshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Zyra e Sekretarit, • Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, • Stafi i Komisionit për Integrimi Evropiane. 	Stafi	Mekanizmat dhe strukturat raportuese janë në vend për të siguruar koordinim me të gjithë aktorët relevantë, në mënyrë që të jenë të informuar në mënyrë adekuate në lidhje me aktivitetet e palëve të ndryshme të interesit.	Në vazhdimësi	Synon të shmangë dublikimin e aktiviteteve të ndryshme, duke siguruar përdorimin më të mirë të burimeve ekzistuese dhe krijimin e sendërgjisë midis drejtorive	00.00